



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.640/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/727-2025, të datës 15 Mars 2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 19.03.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje!, me seli në Prishtinë Anr.640/2025, e datës 17.03.2025, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/727-2025, të datës 15 Mars 2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, lidhur me subjektin politik, Partia Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datë 17.03.2025, në PZAP është parashtruar ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje në të cilën pretendon se në vendvotimet në Skenderaj, kandidati për kryeministër nga radhët e PDK-së, Bedri Hamza në shumicën e vendvotimeve ka marrë 94% e deri në 100% të votave. Duke e marrë për bazë trendin aktual të votave në vendvotime në Kosovë, pothuajse është e pamundur që kandidatët për kryeministër të kenë 100% të votave në vendvotime të caktuara. Andaj, për shkak të dyshimit të bazuar mbi nivelin lartë të përqindjes së votave të fituara nga kandidati i PDK-së, Bedri Hamza, dhe manipulimeve të ndryshme që kanë ndodhur në këto kuti votimi, kërkojnë të bëhet rinumërimi në vendvotimet në komunën e Skenderajit si në vijim: 1.0101/01 6) 0106/02 11) 2041/02 0217/02 0416/03 0601/02 0319/02 2.0101/02 7) 0106/03, 12) 2041/02 0222/01 0225/03 0423/03 0601/11 0401/04, 3.0101/04 8) 0107/01 13) 0202/02 0228/0 0309/01 0426/02 0604/01 0218/01 4.0102/04 9) 0109/01 14) 0203/03 0231/0 0319/01 0432/0 0604/03 0218/02, 5.0103/04 10) 0113/01 15) 0203/09 0232/01 0402/02 0524/01 0225/02 0218/03. Sipas parashtruesit të ankesës kjo situatë është për shkak se kandidati i PDK-së z Bedri Hamza si psh në

vendvotimet në Komunën e Skenderaj-it, 0203/03, 0114/01, 0109/01, 0106/02, 0106/03, 100% etj, të votave, ndërsa në vendvotimet brenda të njëjtës komunë sillen nga 94% deri 100% të votave.

Më datë 18.03.2025, PZAP-i, ka pranuar një shkresë nga parashtuesi i ankesës Subjekti Politik LVV, për plotësimin e ankesës Anr.640/2025, të datës 17.03.2025, në të cilën pretendohet se në ankesën e dorëzuar me datë 17 mars 2025, ora 15:30, iu është përvjedhur një gabim teknik duke e cekur "që vendvotimet janë në komunën e Skenderaj-it". Më tej informojnë se vendvotimet e përshkruara në ankesën Anr.640/2025, janë në komuna të ndryshme, por jo në Komunën e Skenderaj-it, dhe se gabimi i përvjedhur është tërësisht teknik dhe mbi bazën e legjislacionit në fuqi kërkojnë të merret parasysh plotësimi i ankesës, me qëllim që gjatë shqyrtimit të ankesës, paneli të vlerësojë vetëm vendvotimet e përshkruara në ankesë, e të cilat janë në komuna të ndryshme, por jo Komunën e Skenderaj - it.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar më datë 18.03.2025, theksohet se KQZ, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 paragrafi 2.9, nenin 106 dhe nenin 111 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 9 paragrafi 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore, pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), fletëvotimeve nga votimi me kusht, fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta dhe fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me vendimin Nr.01/727/2025, të datës 15.03.2025, ka shpall rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 9 Shkurt 2025. KQZ, gjithashtu në vendimin për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, ka njoftuar se palët të cilët konsiderojnë se të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojnë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e rezultateve. Më tej në përgjigje në ankesë KQZ, shton se ankesa lidhur me rinumërimin e votave në vendvotimet e komunës së Skenderajt, bazohet në trend e jo në prova që dëshmojnë pa rregullsi. Për më tepër i referohen vendvotimeve të komunave tjera e jo ato të Skenderaj. KQZ, në përgjigje ka bashkangjitur tabelën e vendvotimeve, të Komunës së Skenderaj.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën, vëren se ankesa është e pa bazuar.

Paneli i vlerësoi te paqëndrueshme pretendimet e parashtuara në ankesë nga subjekti politik me të cilën pretendon se kandidati për kryeministër nga radhët e PDK-së Bedri Hamza në shumicën e vendvotimeve ka marrë 94% e deri në 100% të votave duke kërkuar rinumërimin e votave në disa vendvotime. Paneli duke shqyrtuar ankesën dhe bazuar edhe në përgjigjen në ankesë vlerësoi se ky pretendim ankimor është i paargumentuar, rrjedhimisht edhe i pa bazuar, pasi që duke marrë parasysh faktin se barra e provës i takon parashtuesit të ankesës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, e në rastin konkret ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të vetme për ti vërtetuar pretendimet ankimore.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili përcakton se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*". Paneli vlerësoi se parashtuesi i ankesës, nuk ka ofruar asnjë dëshmi me ankesë, me të cilën do të provohet fakti për manipulimin e votave në kutitë e votimit të cituara në ankesë nga subjekti politik PDK për kandidatin për Kryeministër z. Bedri Hamza, ngase duke u bazuar në nenit 117

paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit për faktet e pretenduara bie mbi ankuesin. Sipas vlerësimit të panelit vetëm supozimi i ankuesit se është bërë manipulim në vendvotime është arsye e pamjaftueshme për tu aprovuar ankesa siç pretendon ankuesi. Sipas vlerësimit të Panelit lartësia e përqindjes së votave të marra nga subjekti politik PDK, përkatësisht, kandidati për Kryeministër z. Bedri Hamza, nuk është bazë për anulimin e votave në disa vendvotime, pa u provuar paraprakisht nga ankuesi me prova konkrete se subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës ka bërë manipulim i votimit për kandidatin për Kryeministër.

Mbi këto arsye, e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.640/2025, datë 19.03.2025



Këshillë Juridike: kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.